

VENDIM
Nr. 17, datë 18.1.2023

**PËR NGARKIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT, SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR REALIZIMIN E
KONKURSIT TË PROJEKTIMIT PËR PROJEKTIDETË E RIKONCEPTIMIT TË
KOMPLEKSEVE SPORTIVE TË STADIUMEVE NË QYTETET E Durrësit,
KORÇËS DHE VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të komplekseve sportive, si më poshtë vijon:

- a) Stadiumi “Niko Dovana”, Durrës;
- b) Stadiumi “Skënderbeu”, Korçë;
- c) Stadiumi “Flamurtari”, Vlorë.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku